VENDIM
Nr. 502, datë 27.7.2022

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), BASHKIA KURBIN, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KURBIN SI NJËSI ZBATUESE

(Ndryshuar me VKM nr. 831, datë 26.12.2024; nr. 761, datë 19.12.2025)
(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për rindërtimin në truallin ekzistues të 2 (dy) njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Kurbin, në masën 333 152 272 (treqind e tridhjetë e tre milionë e njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) rindërtimin e pallatit nr. 3, në masën 166 576 136 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH;

b) rindërtimin e pallatit nr. 4, në masën 166 576 136 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

2. Bashkisë Kurbin, në buxhetin e vitit 2022, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 66 630 454 (gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e tridhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, për rindërtimin në truallin ekzistues të 2 (dy) njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Kurbin, i cili do të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë.

2/1. Bashkisë Kurbin, në buxhetin e vitit 2024, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 103 958 252.99 (njëqind e tre milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e dy presje nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, për rindërtimin në truallin ekzistues të 2 (dy) njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Kurbin, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024.

2/2. Bashkisë Kurbin, në buxhetin e vitit 2025, i transferohet fondi, në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 160 697 649, 01 (njëqind e gjashtëdhjetë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e dyzet e nëntë presje zero një) lekë pa TVSH, për rindërtimin në truallin ekzistues të 2 (dy) njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Kurbin, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2025.

3. Caktimin e Bashkisë Kurbin si njësi zbatuese për financimin e rindërtimit në truallin ekzistues të 2 (dy) njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Kurbin.

4. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj